

Njoftim i përqendrimit me të cilin Shoqëria Aksionare e Ndërmarrjes Publike të Energjisë Elektrike, Greqi do të fitojë kontrollin e vetëm të drejtpërdrejtë mbi shoqëritë e mëposhtme: Feliks Renjuvabl Holdings S.R.L., Republika e Rumanisë, TMK Hidroenerxhi Pauer S.R.L., Republika e Rumanisë dhe kontroll indirekt mbi Ovidiu Development S.A., Republika e Rumanisë, Tomis Tim S.A., Republika e Rumanisë dhe M.V. Tim Invest S.R.L., Republika e Rumanisë

(lënda nr. 08-128 /2024)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 29.08. 2024, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim që i referohet marrjes së kontrollit të vetëm nga Shoqëria Aksionare e Ndërmarrjes Publike të Energjisë Elektrike me seli në 30 Halkokondili rr. 10432, Athinë, Republika e Greqisë mbi shoqëritë: Feliks Renjuvabl Holdings S.R.L. me seli 15 Sheshi Sharl de Gol, Kati i 5-të, Distrikti 1, Bukuresht, Republika e Rumanisë dhe TMK Hidroenerxhi Pauer S.R.L. me seli ne rr 4B. Primaverii, kati 1, Reshita, Qarku Karash-Severin, Republika e Rumanisë dhe kontrolli indirekt mbi shoqëritë: Ovidiu Development S.A. me seli ne rr 2B. Ion Ionesku De La Brad, Kati 2, Zyra 1, Distrikti 1, Bukuresht, Republika e Rumanisë, Tomis Tim S.A. me seli ne rr 2B. Ion Ionesku De La Brad, Kati 2, Kancelaria 2, Distrikti 1, Bukuresht, Republika e Rumanisë dhe M.V. Tim Invest S.R.L. me seli ne rr 2B. rr. Ion Ionesku De La Brad, Kati 2, Kancelaria 3, Distrikti 1, Bukuresht, Republika e Rumanisë.

-Shoqëria Aksionare e Ndërmarrjes Publike të Energjisë Elektrike është prodhuesi dhe furnizuesi kryesor i energjisë elektrike në Greqi. Shoqëria Aksionare e Ndërmarrjes Publike të Energjisë Elektrike është shoqëria udhëheqëse e Grupit PPK.

Aktivitetet kryesore të Grupit PPK përfshijnë prodhimin, shpërndarjen dhe furnizimin me energji elektrike, në Greqi dhe në Rumani. Grupi PPK është gjithashtu aktiv në shitjen me pakicë të pajisjeve elektrike dhe elektronike

Në Maqedoninë e Veriut, PPK, drejtpërdrejt, ka një shoqëri të varur të regjistruar - Shoqëria për Tregti dhe Shërbime ENERXHI DELIVERI SOLUSHNS AD Shkup, shoqëri e themeluar sipas ligjeve të Maqedonisë së Veriut, me adresën e Stoltenbergova nr. 4, ndërtesa 1/B5-1 kati 1 SU nr. 4, Qendra, Shkupi, Maqedonia e Veriut dhe aktiviteti prioritar i regjistruar - tregtia e energjisë elektrike.

-Feliks Renjuvabl Holdings S.R.L. është një shoqëri holding.

-Tomis Team S.A., Ovidiu Development S.A. dhe TMK Hidroenerxhi Pauer S.R.L. operojnë disa impiante të prodhimit të energjisë elektrike (centrale me erë, mikro-hidro dhe fotovoltaike) me një kapacitet total prej rreth 629 MW.

-M.V. Tim Invest S.R.L. është pronar i një prej parqeve me erë që operohen nga Tomis Tim.

-TMK Hidroenerxhi Pauer S.R.L., Ovidiu Development S.A. dhe Tomis Tim S.A. janë gjithashtu përfitues të Skemës së Mbështetjes së Certifikatave të Gjelbra (Green Certificates Support Scheme) që është në fuqi në Rumani, e prezantuar me qëllim nxitjen e investimeve në prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme (energji elektrike nga OIE).

shoqëritë e synuara nuk kanë shoqëri apo filiale të regjistruara të varura në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Për qëllimet e këtij Njoftimi, tregjet përkatëse të produkteve mund të përkufizohen si tregu i prodhimit dhe furnizimit me energji elektrike me shumicë në Maqedoninë e Veriut dhe tregu i furnizimit me energji elektrike me pakicë në Maqedoninë e Veriut.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

30.08.2024

Shkup